

## Vendim nr. 239 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Sonila Bejtja, Anëtare

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ILIRJAN GJONI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2423, datë 06.06.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar në pozicionin e sekretarit/arkivistit/magazinierit në Degën Doganore Tre Urat, Përmet (*Dogana Përmet*). Me vendimin nr. 26151/3, datë 14.12.2015 të Komisionit Disiplinor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ndaj tij është dhënë masa disiplinore e largimit nga puna me motivacionin e shkeljes së përsëritur të orarit të punës.

2. Duke mos qenë dakord me vendimin, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, për të kërkuar marrjen e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës dhe dëmshpërblime të tjera të lidhura, kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe urdhërimin e punëmarrësit t'i paguajë atij pagën deri në ditën e kthimit në vendin e punës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 137, datë 02.03.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë për pjesën e shfuqizimit të vendimit të Komisionit Disiplinor për largimin nga puna dhe rikthimin e kërkuesit në pozicionin e mëparshëm të punës, ndërsa ka vendosur rrëzimin për pjesën tjetër. Kundër atij vendimi ka ushtruar ankim Dogana Përmet.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1065, datë 11.05.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e padsisë për pjesën e dëmshpërblimit dhe rrëzimin për pjesën tjetër. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesi, Dogana Përmet dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomën e këshillimit dhe ka vlerësuar se, në rastin konkret, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga gjykatat më të ulëta, çështja duhej zgjidhur në themelin e saj nga vetë ai kolegji, përderisa zbatimi i drejtë i ligjit nuk diktohej nga nevoja për rivlerësimin e fakteve ose provave. Në përfundim, Kolegji Administrativ, me vendimin nr. 00-2023-2423, datë 06.06.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 1065, datë 11.05.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 137, datë 02.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, si dhe rrëzimin e padsisë.

5. Në datën 09.09.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në datën 10.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se prej vendimeve të kundërshtuara i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuat, duke e shqyrtuar çështjen në themel si gjykatë fakti, për më tepër në dhomën e këshillimit, edhe pse të dyja gjykatat më të ulëta i kanë

shqyrtuar ato fakte. Ajo gjykatë edhe pse deklaroi se nuk i analizoi provat, qartazi e ka bërë në rastin e kërkuarit, duke shqyrtuar materialet e dosjes gjyqësore dhe duke cituar faktet. Në rast paqartësie, ajo duhet ta kishte thirrur kërkuarin në seancë për sqarime ose t'i kishte njoftuar atij datën e seancës, duke i kërkuar edhe një memo shtesë për pretendimet ose kundërshtimet e ngritura në rekurs. Nisur nga fakti se këtë praktikë e ka ndjekur në disa raste të tjera, në rastin e kërkuarit ajo gjykatë është treguar e njëanshme, duke cenuar edhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

6.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, si dhe parimit të barazisë së armëve e të kontradiktoritetit*, pasi qëndrimi jurisprudencial kushtetues orienton respektimin e së drejtës së personit për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, që përfshin edhe një sërë detyrimesh, me synim realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata.

6.3. *Standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me parimin e mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka arsyetuar mbi ekzistencën e shkaqeve diskriminuese për shkak të gjendjes familjare të kërkuarit dhe përgjegjësisë së tij ndaj nënës së sëmurë. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka arsyetuar mbi kërkimin e kërkuarit për kthimin në punë, si dhe ka zbatuar ligjin në mënyrë të gabuar, duke e rrëzuar padinë në tërësinë e saj edhe pse neni 154 i Kodit të Punës parashikon se punëmarrësi i pushuar nga puna në mënyrë të menjëhershme e të justifikuar ruan të drejtën e shpërblimit për pushimet e pamarra.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar

në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin tjetër paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, me anë të të cilit ka ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin e datës 06.06.2023 të Gjykatës së Lartë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 08.08.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 09.09.2024, pra pas 13 muajve. Kolegji vëren, gjithashtu, se kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 16.05.2024, në të cilën, nëpërmjet shërbimit postar, i është përcjellë shkresa me nr. 2308/1 prot., datë 10.05.2024, lënda “Kthim përgjigjeje” e asaj gjykate. Ai ka pretenduar se ajo gjykatë nuk e ka njoftuar vendimin e arsyetuar edhe pse të dhënat elektronike dhe adresa e banimit të tij janë vënë në dispozicion që me kërkesëpadinë drejtuar gjykatës së shkallës së parë me mjetet ankimore në vazhdimësi.

12. Referuar standardeve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe dokumentacionit në dosje, Kolegji konstaton se kërkuesi ka marrë njoftim për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 08.08.2023, kur ai është publikuar në faqen zyrtare dhe është bërë i

disponueshëm për palët. Ndaj dhe Kolegji vlerëson, duke pasur parasysh sa më lart, se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuksi me paraqitjen e rekursit, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, ndaj ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e ankimit të tij. Përkundër pretendimit të kërkuksit, Kolegji konstaton se në rekursin dhe kërkesëpadinë e paraqitur nga ana e tij, bashkëlidhur kërkesës, nuk rezulton që avokati i tij ose vetë ai, të jenë kujdesur për të shënuar të dhënat elektronike të kontaktit, me qëllim realizimin e njoftimeve nga sekretaria e asaj gjykate, çka do të mundësonte njoftimin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Nga ana tjetër, argumenti i kërkuksit se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në kohën kur kjo e fundit i ka kthyer përgjigje me shkrim atij, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të provuar momentin e konstatimit të cenimit, për sa kohë që një informacion i tillë mund të kërkohej në çdo rast dhe në çdo kohë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor.

13. Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë jashtë afatit ligjor 4-mujor, ndaj kriteri paraprak për legjitimitimin *ratione temporis* nuk plotësohet. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.